

Data 18.09.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Sigurimi shëndetësor privat (i jetës dhe i shëndetit) të punonjësve të ERE” (procedurë e hapur)

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 66512200-4; 66511000-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 21.911.000 Lekë (njëzet e një milion e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Enti Rregullator i Energjisë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Kriteret e veçanta të kualifikimit:

2.1.1. Operatorët ekonomikë, në zbatim të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit” duhet të paraqesin Licencë “Për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit” (Veprimtaria e sigurimit të jojetës), Klasa 1 “Sigurimi i aksidentëve” dhe Klasa 2 “Sigurimi i sëmundjeve”, lëshuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1 e LPP dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kriter i vendosur për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale të operatorëve ekonomikë në lidhje ushtrimin e aktivitetit objekt procedure prokurimi.

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin Vërtetim nga Drejtoria Tatimore për xhiron e realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2020-2021-2022). Kërkesa për plotësimin e kapacitetit financiar konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros për të paktën në një nga tre vitet e fundit financiar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”. Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të pasqyrave financiare të tre viteve të fundit (2020, 2021, 2022), që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e L.P.P, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, indryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumë prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 %, të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët Ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 %, të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben Autoriteti Kontraktor, për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në këtë fushë. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe/ose atë publik.

Nëpunësi i autorizuar i njësisë së prokurimit që do të kryejë veprimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) caktohet Olgerta Gjokutaj.

Njësia e Prokurimit

- | | | |
|----|------------------|---|
| 1. | Olgerta Gjokutaj | Anëtare/Personi Përgjegjës për Prokurimin |
| 2. | Agron Qerimi | Anëtar |
| 3. | Zarina Pulaha | Anëtare |